



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23. 07.2024

Nr: 118

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË AGRARE AMBJENTALISTE TË  
SHQIPËRISË PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E  
PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Sot më datë 23.07.2024, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 2090 Prot., datë 22.07.2024, me:

**Kërkues:** “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë”, me kryetar z. Agron Duka.

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë” (PAA), si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

**VËREJ:**

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 244, datë 5.7.2024, ka caktuar datën 4 Gusht 2024, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë.

Data: 23.07.2024 Nr:118  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”.

“Partia Agrare Ambientaliste Shqipërisë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Agron Duka, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 Gusht 2024.

Nga “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë” është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 22.07.2024, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”, me initiale “PAA”, me kryetar z. Agron Duka, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë” me shkronja nistore “PAA”, me adresë Rruga “Pjetër Budi”, Nr.6, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Agron Duka, me adresë Rruga “Pavarësia”, Lagjia nr.13, nr. 227, Plazh Durrës;
- c) Financieri i partisë është z. Tom Borova, me adresë Rruga “Ali Visha”, Pallati 1, Shkalla 2, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Thoma Miço me adresë “Rruga e Elbasanit”, ndr. 45, H 10, Ap.33, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”, respekton afatin kohor të parashikuar në vendimin nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

## VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”, me kryetar z. Agron Duka, me shkronjat nistore “PAA”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 04 Gusht 2024.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orë nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 23.07.2024 Nr:118  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”.